



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

(Draft 3, Version 1 datë 23.04.2014)

Nr. _____, datë _____

“MBI RIKUPERIMIN E AVUJVE TË BENZINËS NË FAZËN II GJATË MBUSHJES SË MJETEVE MOTORIKE NË STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës “d” të nenit 14 të draftit 3, versionit 3 të Ligjit nr. , datë__ “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër”, me propozim të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të pakësojë sasinë e avullit të benzinës të lëshuar në atmosferë gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve duke përcaktuar masat përkatëse.
2. Ky vendim mbulon të gjithë stacionet e shitjes së karburanteve.

II. PËRKUFIZIME

3. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. "Avulli i benzinës" është çdo përbërës i gaztë që avullon nga benzina;
 - b. "Benzinë" është benzina sipas përcaktimit në Vendimin nr. datë...“Mbi masat për kontrollin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga terminalët në stacionet e shitjes së karburanteve;
 - c. "Eficienca e kapjes së avujve të benzinës” është sasia e avujve të benzinës të kapur nga Faza II e sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës të krahasuar me sasinë e avujve të benzinës që përndryshe, do të ishte lëshuar në atmosferë, në mungesë të një sistemi të tillë dhe e shprehur në përqindje;

¹Ky vendim përafrohet Direktivën 2009/126/EC mbi Fazën II të rigjenerimit të avullit të benzinës gjatë mbushjes së mjeteve motorike në pikat e shitjes. Numri CELEX 32009L0126. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.285, datë 31.10.2009 fq. 0036 – 0039.

- d. "**Faza II e sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës**" është pajisja që ka si qëllim rikuperimin e avujve të benzinës të zhvendosur nga depozita e karburantit të mjetit motorik gjatë mbushjes në stacionin e shitjes së karburanteve, e cila i tranferon ato në depozitën e magazinimit në stacionin e shitjes së karburantit ose e kthen në automatin shpërndarës të benzinës për t'u rishitur;
- e. "**ISHMPU**" është Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin, Pyjet dhe Ujërat sipas përcaktimit të Vendimit nr 46, datë 29.1.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave";
- f. "**Ministër**" është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
- g. "**Ministria**" është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
- h. "**Palë e tretë**" ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në ligjin nr.9824, datë 1.11.2007 "Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë";
- i. "**Raporti avull/benzinë**" është raporti midis vëllimit në presion atmosferik të avujve të benzinës që kalon përmes Fazës II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës dhe vëllimit të benzinës të shpërndarë;
- j. "**Rendiment**" është sasia totale vjetore e benzinës të shkarkuar nga kontenierët e lëvizshëm në stacionin e shitjes së karburanteve;
- k. "**Stacion shitje karburanti**" është stacioni i shitjes së karburanteve sipas përcaktimit në Vendimin nr. ...datë.... "Mbi masat për kontrollin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga терминаlet në stacionet e shitjes së karburanteve;
- l. "**Stacion ekzistues për shitje karburantesh**" është stacioni i shitjes së karburantit që është ndërtuar ose për të cilin është dhënë leje zhvillimi, leje ndërtimi ose leje përdorimi përpara datës 1 Janar 2012;
- m. "**Stacion i ri për shitje karburantesh**" është stacioni i shitjes së karburanteve i ndërtuar ose për të cilin është dhënë leje zhvillimi, leje ndërtimi ose leje përdorimi, në ose pas datës 1 Janar 2012;

III. STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE

4. Operatori i çdo stacioni të ri për shitjen e karburanteve e pajis atë me Fazën II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës në qoftë se:
 - a. rendimenti i tij aktual ose i synuar është më i madh se 500 m³/në vit; ose
 - b. rendimenti i tij aktual ose i synuar është më i madh se 100 m³/në vit dhe është vendosur në zona banimi të përhershme ose zona ku punohet
5. Operatori i çdo stacioni ekzistues për shitjen e karburanteve që i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm, e pajis atë me Fazën II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës, gjatë kohës së rinovimit në qoftë se:
 - a. rendimenti i tij aktual ose i synuar është më i madh se 500 m³/në vit; ose
 - b. rendimenti i tij aktual ose i synuar është më i madh se 100 m³/në vit dhe është vendosur në zona të përhershme banimi ose zona ku punohet.
6. Operatori i çdo stacioni ekzistues për shitjen e karburanteve me rendiment mbi 3000 m³/në vit e pajis atë me Fazën II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës jo më vonë se data 31 Dhjetor 2018.
7. Dispozitat e parashikuara në paragrafin 4, 5 dhe 6 nuk zbatohen për stacionet e shitjes të karburanteve që përdoren ekskluzivisht si shoqëruese të ndërtimit dhe shpërndarjes së mjeteve të reja motorike.

8. Operatori i stacionit të shitjes së karburanteve instalon një sistem monitorimi automatik, për zbuluar automatikisht defektet e funksionimit të Fazës II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës dhe të vetë sistemit të monitorimit automatik. Sistemi i monitorimit automatik i tregon operatorit defektet në stacionet e shitjes së karburanteve dhe ndalon automatikisht rrjedhjen e benzinës nga shpërndarësi që ka defekt, në qoftë se defekti nuk është detektuar brenda 7 ditëve.

IV. NIVELI MINIMAL I RIKUPERIMIT TË AVUJVE TË BENZINËS

9. Nga data e përcaktuar në Kreun III, për fillimin e zbatimit të Fazës II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës, efienca e kapjes së avujve të benzinës e sistemeve të tilla duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 85 % sipas çertifikimit nga fabrikuesi në përputhje me standardet Evropiane teknike përkatëse ose procedurat e miratimit të tipit ose, në qoftë se nuk ka standarde ose procedura të tilla, me standardet shqiptare përkatëse.
10. Nga data e përcaktuar në Kreun III, për fillimin e zbatimit të Fazës II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës, kur avujt e rikuperuar të benzinës transferohen në depozitën e magazinimit në stacionin e shitjes së karburanteve raporti avull/benzinë duhet të jetë i barabartë ose më i madh se 0,95 por më i vogël se 1,05.

V. KONTROLLET PERIODIKE DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

11. ISHMPU/operatori ose në emër të tij, një palë e tretë e akredituar teston eficientë e kapjes së avujve të benzinës të Fazës II të sistemeve të rikuperimit të avujve të benzinës në shërbim të paktën një herë në vit për të kontrolluar përputhshmërinë me dispozitat e parashikuara në paragrafin 10. Kjo bëhet duke kontrolluar raportin avull/benzinë në kushte të simuluar të rrjedhjes së benzinës ose me çdo metodologji tjetër të përshtatshme.
12. ISHMPU/operatori ose në emër të tij, një palë e tretë e akredituar teston sistemin automatik të monitorimit kudo që është instaluar, të paktën një herë në çdo 3 vjet.
13. Kur operatori i stacionit të shitjes së karburanteve instalon Fazën II të sistemit të rikuperimit të avujve të benzinës, ai vendos një shenjë, shpallje apo njoftim tjetër mbi shpërndarësin e benzinës ose në afërsi të tij, për të informuar konsumatorin për këtë fakt.

VI. AUTORITETET KOMPETENTE

14. Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij vendimi janë:
 - a. Ministria;
 - b. ISHMPU.

VII. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi 5 vjet pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA